

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shërbim mirëmbajtje për pajisjet e kondicionimit

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

CPV: 45331000-6 - Punime ngrohje, ventilimi dhe kondicioneresh

VLERA E FONDIT LIMIT: Shumatore e çmimeve për njësi: **3 079 185** *(tre milion e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë pa Tvsh.* Nuk duhet të tejkalohet vlera e kontratve të pritshme që është: **23 333 325** *(njëzet e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e pesë) Lekë pa Tvsh.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NS - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- NS - 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore në fuqi. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në

sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Kjo certifikatë është kërkuar pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata shërbimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën Joproduktive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr.667, datë 29.07.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Certifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit

të miratuar” (i ndryshuar). Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të jetë jo më e ulët se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin nr.7, datë 10.01.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” (të ndryshuar), ku citohet“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.... Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se 40% e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të kryera ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 47 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Personin Përgjegjës (ose drejtuesin teknik) për kryerjen e shërbimeve (*me profesion inxhinier mekanik/hidroteknik/elektrik/elektronik*) të shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Mars 2024 - Maj 2024 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2024 - Maj 2024.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Mars 2024 - Maj 2024, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier mekanik/hidroteknik;
- 1 (një) Inxhinier elektrik/elektronik.

Për specialistët e lartë të mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme, diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2024 - Maj 2024.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 8 (tetë) punonjësve për periudhën Mars 2024 - Maj 2024 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Mars 2024 - Maj 2024.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2024 - Maj 2024.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/certifikata/dëshmi kualifikimi profesional të lëshuara nga institucione të akredituara/liçensuara sipas ligjit ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2024 - Maj 2024 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 2 (dy) punonjës specialist ngrohje ftohje;
- ❖ 1 (një) punonjës specialist kondicionimi;
- ❖ 1 (një) punonjës elektromekanik;
- ❖ 1 (një) punonjës elektrikist.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Mars 2024 - Maj 2024.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/ çertifikatë/dëshmi kualifikimi profesional).

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi për pikat 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5; Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për mirëmbajtjen e sistemeve ngrohje-ftohje të objekteve arsimore dhe publike është e nevojshme pasja e një stafi teknik e vërtetuar kjo në bazë të kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe sasinë e shërbimeve që kërkohen. Me qëllim garantimin e realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Përcaktimi që punonjësit nuk mund të kontraktohen nga operatori ekonomik ofertues enkas për këtë procedurë prokurimi vjen si rezultat i një përvoje 20-vjeçare të autoritetit kontraktor në fushën e shërbimit të mirëmbajtjes së objekteve arsimore dhe publike ku kontraktimi për punonjës të specializuar sipas objektit të prokurimit është pothuajse i pamundur pasi përgjithësisht në kohën kur realizohet ky lloj shërbimi kërkesa e tregut të punës për këta punonjës është e madhe.

2.3.2 Kriteri për të patur në stafin e operatorit ekonomik ofertues një përgjegjës për shërbimet ose drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve. Detyrimi i administratorit të operatorit ekonomik ofertues për të përcaktuar me shkresë Drejtuesin Teknik të shërbimeve objekt të kontratës është bazuar në Ligjin nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.3 Kërkesa për inxhinierët e kërkuar për kryerjen e shërbimeve të parashikuara është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fuqi. Mungesa e këtij stafi të specializuar pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimeve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Është kërkuar inxhinier mekanik/hidroteknik për zbatimin e shërbimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventiv, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri mekanik/hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e shërbimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet. Është kërkuar inxhinier elektrik/elektronik për faktin që natyra e shërbimeve, për zërat kryesore të preventivit që është riparimi dhe mirëmbajtja periodike e pajisjeve të ngrohje-ftohjes në objektet arsimore dhe publike, prandaj rezulton se duhet patjetër që ndërhyrja profesionale në këto sisteme të kontrolluara në mënyrë automatike të realizohet nga një specialist i kualifikuar.

2.3.4 Për sa i përket përcaktimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zbërthimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përlllogaritura në bazë të parashikimeve periodike.

2.3.5 Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i preventivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) 2 (dy) punonjës specialist ngrohje ftohje të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës specialist ngrohje ftohje i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt.
- b) 1 (një) punonjës specialist kondicionimi i kualifikuar është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme sipas grafikut të parashikuar të shërbimeve, është gjykuar që të paktën punonjës specialist kondicionimi i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt.
- c) 1 (një) punonjës elektromekanik i kualifikuar është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës elektromekanik i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt ku është i nevojshëm.

- d) 1 (një) punonjës elektrikist i kualifikuar është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës elektrikist i kualifikuar duhet të jetë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi të gjitha pajisjet e ngohje-ftohjes ushqehen me rrymë elektrike dhe natyra e punës në rrjetet elektrike kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit si “Punonjës specialist kondicionimi i trajnuar për përdorimin e gazrave sipas Ligjit nr.2/2023 datë 26.01.2023 “Për gazet serrë të fluoruara” dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Mars 2024 - Maj 2024 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e nenit 4 pika 5 të Ligjit nr.2/2023 datë 26.01.2023 “Për gazet serrë të fluoruara”. Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara sipas përcaktimeve të nenit 10 pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr.2/2023 datë 26.01.2023 “Për gazet serrë të fluoruara”.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.2/2023 datë 26.01.2023 “Për gazet serrë të fluoruara” i cili përcakton se..... Neni 4 pika 5.... Sipërmarrësi që kryen instalimin, mirëmbajtjen, riparimin ose çaktivizimin e pajisjeve të listuara në shkronjat “a” deri në “d” të pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji, ka detyrimin të ofrojë shërbimin nëpërmjet personave të pajisur me çertifikatën e parashikuar në nenin 10 të këtij ligji dhe të marrë masa paraprake për të parandaluar rrjedhjen e gazeve serrë të fluoruara....., dhe neni 5 pika 4 i cili përcakton se.... 4.Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, personat që zotërojnë çertifikatën përkatëse në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, sigurojnë kryerjen e kontrollit të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara, të përcaktuara si më poshtë: a) pajisje të palëvizshme ftohjeje; b) pajisje të palëvizshme të ajrit të kondicionuar;.....Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me bazën ligjore në fuqi si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që shërbimet të realizohen nga specialistë të trajnuar duke mbrojtur mjedisin, por dhe personat që mund të jenë përreth vendit të kryerjes së shërbimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si “Punonjës specialist kondicionimi i trajnuar për përdorimin e gazrave”, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë mjedisin apo shëndetin dhe sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë shërbimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR)”, në pajtim me Ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, sipas fushës së objektit të veprimtarisë. (në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, mjafton disponueshmëria e 1(një) DVR për të gjithë BOE).

Argumentimi: Në bazë të nenit 3 pika 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 5 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Ligji nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR), i cili provon përmbushjen e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e punonjësve nga risqet e mundshme gjatë ushtrimit të profesionit të tyre nga operatori ekonomik ofertues.

Elementët kryesorë të domosdoshmërisë së hartimit të “Dokumentit të Vlerësimit të Riskut (DVR)” sipas përcaktimeve ligjore, po rendisim si më poshtë:

- a) Të vlerësohen risqet dhe të merren masa mbrojtëse Punëdhënësi kryen një Vlerësim të Riskut lidhur me risqet për SSHP, përfshirë ato me të cilat përballen grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj risqeve të veçanta; ai gjithashtu vendos për masat mbrojtëse që duhen marrë. (Neni 9/1 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).
- b) Të përgatitet një plan i masave parandaluese dhe mbrojtëse Punëdhënësi është i detyruar të hartojë një plan për parandalimin dhe mbrojtjen, që përbëhet nga masa teknike, mjekësore, organizative dhe higjieno-sanitare, për llogari të Vlerësimit të Riskut, që ata duhet të zbatojnë në bazë të kushteve të punës që janë specifike për ndërmarrjen e tyre (Neni 10/b i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).
- c) Të informohen punëmarrësit mbi rezultatet e Vlerësimit të Riskut Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre për çdo risk në vendin e punës, dhe për masat mbrojtëse që duhet të merren për t’i kontrolluar këto risqe dhe për eliminimin e pasojave të tyre të dëmshme. Informacioni mbi rezultatet e Vlerësimit të Riskut dhe masat e marra i vihet në dispozicion punëmarrësve... (Neni 12/1 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).
- d) Punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre të përfshihen në Vlerësimin e Riskut Përfaqësuesit e punonjësve për SSHP marrin pjesë gjatë përgatitjes së Vlerësimit të Riskut dhe planifikimit të masave parandaluese, si dhe dokumenteve të tjera që lidhen me SSHP. (Neni 18 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë)
- e) Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit ka kompetencë të marrë pjesë në vlerësim, të hartojë dhe zbatojë programe për parandalimin e riskut në ndërmarrje; (Neni 20 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).
- f) Të ndiqen parimet e mëposhtme të parandalimit në mënyrë kronologjike:
 - shmangia e risqeve;
 - vlerësimi i risqeve që nuk mund të shmangen;
 - luftimi i risqeve në burim;
 - zëvendësimi i të rrezikshmes me të parrezikshmen ose më pak të rrezikshmen;
 - dhënia prioritet masave mbrojtëse kolektive në raport me masat mbrojtëse individuale;
 - dhënia e udhëzimeve të përshtatshme për punonjësit. (Neni 6/3 i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).

Dokumenti i Vlerësimit të Riskut, i nevojshëm për çdo shoqëri, nëpërmjet vlerësimit dhe analizës së çdo pozicioni pune për gjetjen e situatave me rrezik dhe përgatitjen e një plani masash për uljen ose eliminimin e tij në përputhje me Ligjin nr.10237 datë 18.02.2010 “ Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Automjet ATP	2 copë	Pronësi ose me qira
2	Kompresor vakumi për mbledhjen e gazrave	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	8 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	8 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq 2-6$ kg	2 copë	Pronësi ose me qira
4	Kuti e Ndhmës së shpejtë	2 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), çertifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënesit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.
- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas Shtojcës 9.

Shënim: Ky kriter (2.3.8) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet mirëmbajtjen periodike të pajisjeve ngrohje-ftohje të objekteve arsimore dhe publike, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makineritë dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga Autoriteti kontraktor si të domosdoshme për realizimin e shërbimit në përputhje me ligjislacionin e punës. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre mjeteve teknike.

1) Automjet ATP, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e materialeve të nevojshme për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e objekteve arsimore dhe publike në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, është gjykuar që të paktën 2 (dy) mjete të tillë të jenë të nevojshëm për zbatimin e kontratës.

2) Kompresor vakumi për mbledhjen e gazrave, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh se përcaktimet ligjore në fuqi detyrojnë operatorin ekonomik i cili do zbatojë kontratën objekt të prokurimit të mbledhë brenda mundësive teknike të gjitha gazrat e pajisjeve ngrohëse-ftohëse, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

3) Matrapik, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e parashikuar të riparimeve dhe mirëmbajtjes për realizimin e kontratës, sasinë e pajisjeve ngrohëse-ftohëse dhe shpërndarjen e tyre në objektet arsimore dhe publike, është gjykuar që të paktën 2 (dy) pajisje teknike të tilla janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

4) Për të realizuar me efikasitet mbrojtjen dhe sigurinë në punë për punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës janë kërkuar këto mjete mbrojtëse të pasqyruara në Kreun II të Tabelës në pikën 2.3.10, në përputhje me natyrën e shërbimeve dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimi i Materialeve:

Cilësia e kërkuar për materialet e vendosura për mirëmbajtjen.

Në specifikimet teknike të kondicionerëve dhe chillerave është e domosdoshme të respektohen instruksionet e mirëmbajtjes duke ndjekur protokollin e parashikuar në to. Inxhinieri i zbatimit të mirëmbajtjes duhet të vendosë për pjesë ndërrimi dhe materiale të certifikuara dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve ose ekuivalent.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i mirëmbajtjes së kondicionerëve dhe chillerave përfshin mirëmbajtjen prapake sipas grafikut të urdhëruar nga Autoriteti kontraktor, si dhe riparimet me zëvendësim pjesë ndërrimi. Kondicionerët janë të markave të ndryshme të tregtuara në vendin tonë gjatë 13 viteve të fundit. Prioritet janë objektet parashkollore, çerdhe dhe kopshte të shpërndara në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Tiranë.

Riparimet që do të kontraktohen për mirëmbajtjen duhet të përfshijnë, furnizimin me pjesë ndërrimi, çmontim-montimin si dhe vendosjen në funksionim normal të kondicionerëve dhe chillerave sipas grafikut të ekzekutimit.

Është detyrë e kontraktorit të mirëmbajtjes, zgjedhja e pajisjeve mbështetëse të tilla që mundësojnë realizimin e procesit të mirëmbajtjes dhe përzgjedhjes së “skuadrës së mirëmbajtjes” të aftë për të kuptuar dhe realizuar proceset e mirëmbajtjes të parashikuara në këtë raport.

Ofertuesit duhet të kenë një paketë të plotë të dokumentacionit të funksionimit dhe mirëmbajtjes konsiston në dokumentat e mëposhtëm:

Informacioni teknik

- a) Procedurat rutinë
- b) Procedurat speciale
- c) Defektet më të shpeshta

Manuali i mirëmbajtjes duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

Në “Grafikët e shërbimeve mirëmbajtëse” dhe “Urdhërat e riparimit” duhet të jepen të dhënat e mëposhtme:

- a) Të dhëna të përgjithshme,
- b) Grafikun e ndërhyrjeve të mundshme,
- c) Riparimet e nevojshme,
- d) Garancinë,
- e) Të dhëna mbi instalimin, funksionimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen,
- f) Inventarizimin e pjesëve të ndërrimit,
- g) Veprimet mbrojtëse të mirëmbajtjes (kujdesin ndaj goditjeve elektrike),
- h) Përshkrimin e veprimeve ndërhyrëse,
- i) Historikun e ndërhyrjeve mirëmbajtëse.

Të gjitha materialet dhe pjesët e ndërrimit që do të përdoren për riparime me zëvendësim pjesësh do të jenë materiale të certifikuar dhe origjinale të prodhuara nga prodhuesi i pajisjeve ose ekuivalent që përmbushin standartet CE.

Të gjitha materialet e tjera që do të përdoren për kryerjen e punimeve duhet të plotësojnë kushtet teknike KTZ dhe KTP dhe standartet teknike kombëtare ose ndërkombëtare për çdo produkt të pasqyruar në këtë shtojcë. Në përgjithësi cilësia për materialet e kërkuara është e detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi. Kushtet teknike të zbatimit janë të detajuara tek termat e referencës Shtojca 7. Vendodhjet e objekteve arsimore në të cilat do të kryhen punimet e kërkuara në DST sipas preventivit, gjenden brenda territorit të Bashkisë së Tiranës dhe do të pasqyrohen në kontratë të detajuara.

Shënim: Për **Çdo** standart teknik kombëtar ose ndërkombëtar ose njësi matëse të cilësuar tek specifikimet teknike dhe termat e referencës do të pranohet ekuivalenti i tij në referim të nenit 36 pika 3 ç) të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

Objekti i Shërbimit mirëmbajtës: Sigurimi i gatishmërisë teknike dhe funksionimit normal të pajisjeve të kondicionimit (kondicionerë dhe chillera) duke krijuar kushte optimale pune. Hartimi i manualit të përdorimit dhe mirëmbajtjes.

Qëllimi i shërbimit mirëmbajtës: Mundësimi i një kontrate për **riparim-mirëmbajtje** të pajisjeve të kondicionimit në objekte parashkollore, shkollore dhe ambiente të tjera në juridiksionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Të gjitha materialet e tjera që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje duhet të jenë të certifikuar konform standartit (CE). Në përgjithësi materialet e kërkuara janë të specifikuar edhe në listën e çmimeve apo formularin e shërbimeve, dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga ofertuesi.
Detyrat:

Kontrata zbatohet me grafik riparim-shërbimesh të programuara mujore dhe urdhëra riparimi të lëshuara nga AK sipas nevojave. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës do të mbajë kontak të përditshëm me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e planit (procedurës) të zbatimit të kontratës, plan të cilin OE dhe AK e nënshkruajnë brenda 7 (shtatë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Shpërndarja: Objektet arsimore dhe publike në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë

Shërbimet që kërkohen të kryhen:

Bazuar në marrëveshjen Kuadër që do të lidhet me OE të sukseshëm, Autoriteti kontraktor do të lidhë (mini)kontrata sipas nevojave për të arritur të funksionojnë normalisht të gjitha kondicionerët nëpërmjet kryerjes së shërbimeve teknike të programuara dhe riparimeve të nevojshme. Do të kërkohet realizimi i të gjithë shërbimeve të parashikuara si dhe riparimet e nevojshme në llojshmëri. **Sasia është e pritshme.**

Afatet e ekzekutimit:

Kontratat e lidhura bazuar në Marrëveshjen Kuadër do të zbatohen si vijon:

1. Për shërbimet teknike mirëmbajtëse, me njësi matëse "Orë pune", hartohet Grafik shërbimesh të programuara nga grupi i punës për ndjekjen e zbatimit të kontratave. OE merr një kopje dhe e zbaton në sasi, cilësi dhe afatin e urdhëruar.
2. Për riparime me njësi matëse "F.v. (furnizim vendosje)", me lindjen e nevojave, Grupi i punës lëshon "Urdhër riparimi" ku jepet sasia, çmimi njësi sipas kontratës lidhur në bazë të MK dhe afati i ekzekutimit (realizimit).

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

NJËSIA E PROKURIMIT